



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.132

1 tetor

2010

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Vendim i KM nr.712, datë 25.8.2010	Për miratimin, në parim, të marrëveshjes së paradhënies për përgatitjen e projektit të propozuar për burimet ujore dhe ujitjen, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) 6989
Vendim i KM nr.739, datë 8.9.2010	Për dhënie ndihme financiare një kategorie personash të strehuar në Republikën e Shqipërisë 6989
Vendim i KM nr.740, datë 8.9.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga zgjerimi i varrezave publike, në bashkinë e Bilishtit 6990
Vendim i KM nr.741, datë 8.9.2010	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Kryevidh të qarkut të Tiranës 6991
Vendim i KM nr.742, datë 8.9.2010	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Drenovë të qarkut të Korçës 6992
Vendim i KM nr.743, datë 8.9.2010	Për një shtesë në vendimin nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, të ndryshuar 6993
Vendim i KM nr.745, datë 15.9.2010	Për disa shtesa në vendimin nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, të ndryshuar 6994
Vendim i KM nr.746, datë 15.9.2010	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të kurimit të z. Niko Verushi, në Francë..... 6996

Vendim i KM nr.747, datë 15.9.2010	Për rishpërndarje fondesh, brenda buxhetit të vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë	6997
Vendim i KM nr.748, datë 15.9.2010	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e vitit 2010	6997
Vendim i KM nr.751, datë 8.9.2010	Për disa shtesa në vendimin nr.824, datë 6.12.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e institucioneve të autorizuar për verifikimin në mënyrë elektronike të gjendjes gjyqësore, si dhe të formularit të vetëdeklarimit, të ndryshuar	6998
Vendim i KM nr.753, datë 8.9.2010	Për bashkëpunimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës me institucionet në varësi të Ministrisë së Financave	6998
Vendim i KM nr.754, datë 8.9.2010	Për bashkëpunimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës me institucionet në varësi të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	7002
Vendim i KM nr.756, datë 15.9.2010	Për disa ndryshime në vendimin nr.279, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së produkteve të ndërtimit, për të cilat kërkohet vlerësimi i detyruar i konformitetit”	7002
Vendim i KM nr.757, datë 15.9.2010	Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave, për shitjen e sipërfaqes së domosdoshme të truallit, për ushtrimin e veprimtarisë nga shoqëritë tregtare, ku shteti zotëron kuota apo aksione	7003
Vendim i KM nr.758, datë 15.9.2010	Për përcaktimin e procedurës dhe kriterëve për përzgjedhjen e anëtarëve të bordit drejtues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, nga sektori ekonomik privat, si dhe masën e shpërblimit të anëtarëve të këtij bordi	7005
Udhëzim i MF nr.30, datë 7.9.2010	Për zbatimin e ligjit nr.10 270, datë 22.4.2010 “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij”	7006
Urdhër i MF nr.63, datë 7.9.2010	Për miratimin e formularit të deklarimit dhe pagesës së taksës mbi truallin shtetëror në përdorim	7009
Vendim i BSH nr.56, datë 31.8.2010	Për dhënien e miratimit paraprak për kryerjen e veprimtarisë shtesë nga Banka Credins sh.a.....	7012
Vendim i BSH nr.62, datë 31.8.2010	Për tërheqjen nga qarkullimi të kartmonedhave me kurs ligjor..	7012
Vendim i ERE nr.57, datë 8.9.2010	Për miratimin e studimit të humbjeve teknike për vitin 2009 ...	7013
Vendim i ERE nr.58, datë 8.9.2010	Për fillimin e procedurave të licencimit të shoqërisë “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	7014

Vendim i ERE nr.59, datë 8.9.2010	Për licencimin e shoqërisë “HydroEnergy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike	7015
Vendim i ERE nr.60, datë 8.9.2010	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “Ansara Koncension” sh.p.k.....	7015
Vendim i ERE nr.61, datë 13.9.2010	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit të aplikimit të OSSH sh.a., për miratimin e plant të investimeve të vitit 2011	7016
Vendim i ERE nr.62, datë 13.9.2010	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për vitin 2011.	7017
Vendim i ERE nr.63, datë 13.9.2010	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për vitin 2011	7017
Vendim i ERE nr.64, datë 13.9.2010	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2011	7018
Vendim i ERE nr.65, datë 13.9.2010	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për vitin 2011	7018
Vendim i ERE nr.66, datë 13.9.2010	Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për konsumatorët tariforë	7019
Vendim i ERE nr.67, datë 13.9.2010	Për fillimin e procedurave për miratimin e tarifës së lidhjes së re apo modifikimit të lidhjes ekzistuese në rrjetin elektrik të OST sh.a.	7019
Vendim i ERE nr.68, datë 13.9.2010	Për shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE shoqërisë “Alb Wid Energy” sh.p.k.....	7020

VENDIM
Nr.712, datë 25.8.2010

**PËR MIRATIMIN, NË PARIM, TË MARRËVESHJES SË PARADHËNIES PËR
PËRGATITJEN E PROJEKTIT TË PROPOZUAR PËR BURIMET UJORE DHE UJITJEN,
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26 të ligjit nr.9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në Republikën e Shqipërisë” dhe të neneve 5 e 7 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin, në parim, të marrëveshjes së paradhënies për përgatitjen e projektit të propozuar për burimet ujore dhe ujitjen, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), në shumën prej 1 000 000 (një milion) USD.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.739, datë 8.9.2010

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE NJË KATEGORIE PERSONASH TË STREHUAR
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, dhe të neneve 13, pika 2, e 20 të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e një ndihme financiare, prej 78 000 (shtatëdhjetë e tetë mijë) lekësh në muaj, për pagesën e qirasë së banesës, të ushqimit, të energjisë elektrike e të ujit, çdo shtetasi të huaj, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pagesa të kryhet nga strukturat e Ministrisë së Brendshme, sipas udhëzimit të Ministrit të Brendshëm.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit, në shumën e përcaktuar, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha
6989

Lidhja nr.1

1. Ahmet Adil
2. Abu Bakker Qassim
3. Ala Abdul Maksud
4. Akhadar Qassim Basit
5. Ayoob Haji Mohammed
6. Zakirjan Hassan

Lidhja nr.2 Efektet financiare

Nr.	Emër, mbiemër	Qira	Ndihmë financiare	Muaj	Total ndihmë financiare
1	Ahmet Adil	35 000	43 000	12	936 000
2	Abu Bakker Qassim	35 000	43 000	12	936 000
3	Ala Abdul Maksud	35 000	43 000	12	936 000
4	Akhadar Qassim Basit	35 000	43 000	12	936 000
5	Ayoob Haji Mohammed	35 000	43 000	12	936 000
6	Zakirjan Hassan	35 000	43 000	12	936 000
	Totali/lekë				5 616 000

Për të gjithë shtetasit e sipërpërmendur është parashikuar mbulimi i shpenzimeve të qirave të banesave për një periudhë 12-mujore. Kjo, pasi këta shtetas kanë firmosur kontrata qiraje banese njëvjeçare me agjencinë imobiliare dhe gjykojmë që këto kontrata të përsëriten për një periudhë njëvjeçare.

Për të gjithë shtetasit e sipërpërmendur ndihma financiare është përlogaritur për të mbuluar periudhën shtator 2010-gusht 2011.

VENDIM

Nr.740, datë 8.9.2010

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, TË CILAT PREKEN NGA ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE NË BASHKINË E BILISHTIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5/1, 20 dhe 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i varrezave publike, në bashkinë e Bilishtit.

2. Shpronësimi bëhet në favor të bashkisë së Bilishtit.

3. Pasuritë, në sipërfaqen prej 1800 (një mijë e tetëqind) m² tokë arë, pronë private, që shpronësohen, si dhe lista e pronarëve që shpronësohen, janë sipas tabelës bashkëlidhur këtij projektvendimi dhe pjesë përbërëse e tij.

4. Masa e shpërblimit të pronarëve, pasuritë, pronë private të të cilëve shpronësohen, është 450 900 (katërqind e pesëdhjetë mijë e nëntëqind) lekë.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit të përballohet nga të ardhurat e bashkisë së Bilishtit, planifikuar në buxhetin e saj.

6. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë, 3 (tre) muaj pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga bashkia e Bilishtit.

8. Afati i përfundimit të punimeve për këtë objekt të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga bashkia e Bilishtit për realizimin e tij.

9. Regjistrimi i ri i pasurisë prej 1800 (një mijë e tetëqind) m² tokë arë, shpronësuar në favor të bashkisë së Bilishtit, të bëhet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

10. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia e Bilishtit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

TË DHËNAT MBI LISTËN EMËRORE TË PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR ZGJERIMIN E VARREZAVE PUBLIKE, NË BASHKINË E BILISHTIT

Nr.	Emër, mbiemër	Sip.arë m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera lekë	Numri i pasurisë	Zona kadastrale
1	Nekton Piringu	1800	250.5	450 900	858/15	3804
	Totali	1800		450 900		

VENDIM

Nr.741, datë 8.9.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS KRYEVIDH TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Kryevidh të qarkut të Tiranës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 113 (njëqind e trembëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 794 (shtatëqind e nëntëdhjetë e katër).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kryevidh për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
8-21	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
22-29	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
31-40	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
41-63	Varreza publike	Në pronësi
69,73,76,80,83,85,87,94, 98,99,112,113,114	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi
108-109-110-111	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
115-580	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
581-592	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi

VENDIM
Nr.742, datë 8.9.2010

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS DRENOVË TË QARKUT TË KORÇËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Drenovë të qarkut të Korçës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj komune, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 88 (tetëdhjetë e tetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 534 (pesëqind e tridhjetë e katër).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Drenovë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
71-78	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
87,95-100	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
79-86,88,89,523-526	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
102-110	Varrezat publike	Në pronësi
111-118 (vetëm trojet)	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave dhe objekteve të çdo lloji	Në përdorim
111-118 (vetëm sheshet) 361,362,365,366	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
1-3,5,7,8,12-70,520-522	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
4,6,9-11,345,349,353,355, 358, 360	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi
451-457	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi
500-519	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
528-534	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e pyje & kullota.	Në pronësi

VENDIM**Nr.743, datë 8.9.2010**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.591, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të shkronjës “dh” të pikës 1 të vendimit nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Përfshijmë, lejohet Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimeve, për objektet “Ndërtim rruge, Unaza e Re e Tiranës – Mullet, loti 1”, “Ndërtim rruge, Rruga e Arbërit (Segmenti Dalje, Ura e Vashës – Bulqizë), loti 3” dhe “Ndërtim rruge, By Pass Plepa – Kavajë – Rogozhinë, loti 4.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fyqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Sali Berisha**

6993

VENDIM
Nr.745, datë 15.9.2010

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.591, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE”, TË
NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, të Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në fund të shkronjës “dh” të pikës 1 të vendimit nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohen paragrafët, me këtë përmbajtje:

“Përfundimisht, lejohen të gjitha autoritetet kontraktore të vijnë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për të gjitha blerjet me vlerë më të vogël se 400 000 (katërqind mijë) lekë.

Përfundimisht, lejohet Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, si autoritet kontraktor, të vijnë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit për objektet e mëposhtme:

- i) “Blerje materialesh elektronike profesionale”;
- ii) “Blerje pjesësh këmbimi për automjete”;
- iii) “Blerje materialesh elektrike”;
- iv) “Kontrata për shërbimin e internetit, me kohëzgjatje 16 muaj”;
- v) “Shërbimi celular për administratën e Kuvendit”.

Përfundimisht, lejohet Ministria e Shëndetësisë, si autoritet kontraktor, të vijnë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektet e mëposhtme:

- i) “Blerje materialesh konsumi mjekësor për Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut”;
- ii) “Blerje kit-esh dhe reagent-esh për Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut”;
- iii) “Blerje kit-esh për agentët infektivë të kontrollit të gjakut, për Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut”;
- iv) “Blerje kit-reagent-esh dhe materialesh konsumi, për laboratorët e drejtorive të shëndetit publik”;
- v) “Blerje vajguri JET A1, për helikopterët e Njesisë së Transportit Mjekësor me Helikopter”;

- vi) “Kryerje e implantit koklear për disa fëmijë”;
- vii) “Blerje vaksinash të rralla antirabike dhe sezonale”.

Përfundimisht, lejohet Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, si autoritet kontraktor, të vijnë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektet e mëposhtme:

- i) “Mirëmbajtje e sistemeve të peshimit”;
- ii) “Blerje vulash metalike për maunet, plumbçe”.

Përfundimisht, lejohet Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si autoritet kontraktor, të vijnë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektin: “Shërbim i ruajtjes me rojë private”.

Përfundimisht, lejohet Gjykata e Lartë, si autoritet kontraktor, të vijnë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektet e mëposhtme:

- i) “Rikonstrukcion i mjediseve në Gjykatën e Lartë”;
- ii) “Blerje pajisjesh elektronike për Gjykatën e Lartë”;
- iii) “Blerje karburanti për Gjykatën e Lartë”.

Përfundimisht, lejohet Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Vlorë, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektin: “Rikonstruksion dhe objekt i ri, Gjykata e Shkallës së Parë, Vlorë”.

Përfundimisht, lejohet Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Korçë, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektet e mëposhtme:

i) “Blerje mobilie dhe pajisjesh elektronike, për ndërtesën e re të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Korçë”;

ii) “Blerje pajisjesh elektronike për ndërtesën e re të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Korçë”.

Përfundimisht, lejohet Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektet e mëposhtme:

i) “Krijimi i mjedisit të shërbimit ndaj publikut në dhomën penale të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë”;

ii) “Studim fizibiliteti për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë”;

iii) “Hartimi i projektzbatimit për krijimin e mjedisit të shërbimit ndaj publikut në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, Tiranë”;

iv) “Blerje mobilie”.

Përfundimisht, lejohet Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Fier, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektin: “Hartimi i projektzbatimit për ndërtesën e re të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Fier”.

Përfundimisht, lejohet Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektin: “Hartimi i projektzbatimit për rikonstruksionin e ndërtesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gjirokastrë”.

Përfundimisht, lejohet Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Pukë, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektin: “Hartimi i projektzbatimit për rikonstruksionin e ndërtesës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Pukë”.

Përfundimisht, lejohet Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Përmet, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektet e mëposhtme:

i) “Blerje pajisjesh elektronike”;

ii) “Blerje mobilie zyre”.

Përfundimisht, lejohet Prokuroria e Përgjithshme, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit për objektet e mëposhtme:

i) “Rikonstruksion i tarracës së ndërtesës dhe garazheve të Prokurorisë së Përgjithshme”;

ii) “Blerje pajisjesh kompjuterike”;

iii) “Ndërtimi i ndërtesës së re të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Korçë”;

iv) “Rikonstruksion i ndërtesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Kurbin”;

v) “Projekt i ndërtesës së re të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, Shkodër”.

Përfundimisht, lejohet Aparati i Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, me fondin limit 36 719 828 (tridhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e tetëqind e njëzet e tetë) lekë, për objektet e mëposhtme:

i) “Linja të tensionit të lartë për PKK-në, Kukës”, me fond limit 11 339 110 (njëmbëdhjetë milionë e treqind e tridhjetë e nëntë mijë e njëqind e dhjetë) lekë;

ii) “Trajnime për Oraclin dhe Memexin”, për specialistët e teknologjisë së informacionit, me fond limit 1 970 000 (një milion e nëntëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë;

iii) “Blerje materiale për prodhimin e vulave”, me fond limit 1 783 243 (një milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind e dyzet e tre) lekë;

iv) “Shërbim për licencat “Oracle””, me fond limit 5 627 475 (pesë milionë e gjashtëqind e njëzet e shtatë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë;

v) “Servera për sistemin “Memex””, me fond limit 5 000 000 (pesë milionë) lekë;

vi) “Shërbim interneti për Policinë e Shtetit”, me fond limit 9 000 000 (nëntë milionë) lekë;

vii) “Riparim kamerash termike”, me fond limit 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekë;

viii) “Shtypshkrime për Policinë Kriminale”, me fond limit 3 500 000 (tre milionë e pesëqind mijë) lekë.

Përfundimisht, lejohet Drejtoria e Policisë së qarkut të Durrësit, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit për objektin “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit”, me fond limit 2 000 000 (dy milionë) lekë.

Përfundimisht, lejohet Drejtoria e Policisë së qarkut të Elbasanit, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit për objektin “Mirëmbajtje e mjeteve të transportit”, me fond limit 2 484 500 (dy milionë e katërqind e tetëdhjetë e katër mijë e pesëqind) lekë.

Përfundimisht, lejohet reparti i policisë, RENE, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektin “Sigurim helikopteri”, me fond limit 7 000 000 (shtatë milionë) lekë.

Përfundimisht, lejohet Qendra e Shërbimeve dhe Administrimit të Mjeteve të Transportit të Ministrisë së Brendshme, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për objektet e mëposhtme:

i. “Blerje filtrash për automjete”, me fond limit 3 508 181 (tre milionë e pesëqind e tetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e një) lekë;

ii. “Blerje pjesësh këmbimi për automjete”, me fond limit 2 572 218 (dy milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e tetëmbëdhjetë) lekë.

Përfundimisht, lejohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si autoritet kontraktor, të vijojë normalisht kryerjen e procedurave të prokurimit, për projektin “Rikonstruksioni i ndërtesës nr.3 në IEVP-në, Lezhë .”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.746, datë 15.9.2010

PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E PJESSHËM TË SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË Z. NIKO VERUSHI, NË FRANCË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, në artikullin “Shpenzime operative”, i shtohet fondi prej 2 500 000 (dy milionë e pesëqind mijë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve të kurimit të z. Niko Verushi, në Francë.

2. Efektet financiare, për mbulimin e këtyre shpenzimeve, përballohen nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave, për zbatimin e këtij vendimi.

4. Pagesat të bëhen kundrejt paraqitjes së faturave origjinale.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.747, datë 15.9.2010

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH, BRENDA BUXHETIT TË VITIT 2010, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E SHËNDETËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 16 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, të bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Në programin buxhetor 07220 “Shërbimet e kujdesit parësor”, të shtohet fondi 300 000 000 (treqind milionë) lekë, në artikullin 604 “Të tjera transferime korente të brendshme”.

b) Në programin buxhetor 07330 “Shërbimet e kujdesit dytësor”, të pakësohet fondi 300 000 000 (treqind milionë) lekë, në artikullin 604 “Të tjera transferime korente të brendshme”.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.748, datë 15.9.2010

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË BUXHETIN E VITIT 2010

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 16 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2010 të bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në programin buxhetor “Arsimi profesional”, zëri “Shpenzime korrente”, t’i zbritet fondi prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh.

b) Grupit “Institucione të tjera qeveritare”, në programin buxhetor “Për shoqëritë e informacionit”, zëri “Shpenzime korrente”, t’i shtohet fondi prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh.

c) Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, në programin buxhetor “Arsimi profesional”, zëri “Shpenzime kapitale”, t’i shtohet fondi prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh.

ç) Grupit “Institucione të tjera qeveritare”, në programin buxhetor “Për shoqëritë e informacionit”, zëri “Shpenzime kapitale”, t’i pakësohet fondi prej 35 000 000 (tridhjetë e pesë milionë) lekësh.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.751, datë 8.9.2010

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.824, DATË 6.12.2006 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E INSTITUCIONEVE TË AUTORIZUARA PËR VERIFIKIMIN NË MËNYRË ELEKTRONIKE TË GJENDJES GJYQËSORE, SI DHE TË FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 7, 8 e 11 të ligjit nr.9614, datë 21.9.2006 “Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore”, me propozimin e Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 38 të kreut I të vendimit nr.824, datë 6.12.2006 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohen pikat 39, 40 e 41, me këtë përmbajtje:

“39. Autoriteti i Aviacionit Civil;

40. Shkolla e Magjistraturës;

41. Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU).”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.753, datë 8.9.2010

PËR BASHKËPUNIMIN E INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS ME INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRISË SË FINANCVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Inspektorati Shtetëror i Punës bashkëpunon me Ministrinë e Financave dhe institucionet në varësi të saj.

2. Inspektorati bashkëpunon me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, për shkëmbimin e informacionit për subjektet, pranë të cilave kanë ndodhur aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale.

3. Informacioni i dërguar nga Instituti i Sigurimeve përmban të dhënat, sipas formularit nr.1 dhe formularit nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

4. Inspektorati Shtetëror i Punës bashkëpunon me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për shkëmbimin e informacionit për subjektet e regjistruara pranë tyre.

5. Informacioni i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve duhet të përmbajë këto të dhëna:

a) emrin e subjektit;

b) prefekturën;

c) rrethin;

ç) NIPT-in;

d) llojin e veprimtarisë;

dh) adresën e qendrës ose filialit;

e) emrin e punëdhënësit;

ë) numrin e punëmarrësve;

f) numrin e punëmarrësve të deklaruar (të siguruar) në tatime, për çdo subjekt, rast pas rasti, për ndryshimin e numrit të punëmarrësve të deklaruar.

6. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

INSTITUTI I SIGURIMEVE SHOQËRORE
DREJTORIA RAJONALE E SIGURIMEVE SHOQËRORE
AGJENCIA

FORMULARI Nr.1

EVIDENCË MBI AKSIDENTET NË PUNË DHE SËMUNDJET PROFESIONALE DHE DITËVE TË PAGUARA PËR TREMUJORIN

[illegible]

Shënim. Kjo evidencë raportohet çdo tremujor nga DRSSH-të brenda datës 5 të muajit pasardhës të tremujorit.

Shënim. Për aksidentet në punë bashkëngjitet dhe fotokopje e procesverbalit të aksidentit.

K/DEGËS SË PËRFITIMEVE

K/DEGËS SË FINANCËS

DREJTORI

EVIDENCË MBI AKSIDENTET NË PUNË DHE SËMUNDJET PROFESIONALE DHE DITËVE TË PAGUARA PËR ---PROGRESIVE---

[illegible]

Shënim. Kjo evidencë raportohet progresive nga DRSSH-të brenda datës 5 të muajit pasardhës të tremujorit.

K/DEGËS SË PËRFITIMEVE

K/DEGËS SË FINANCËS

DREJTORI

VENDIM
Nr.754, datë 8.9.2010

**PËR BASHKËPUNIMIN E INSPEKTORATIT SHETETËROR TË PUNËS ME
INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRISË SË MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.9634, datë 30.10.2006 “Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës”, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Inspektorati Shtetëror i Punës bashkëpunon me institucionet në varësi të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për:

a) shkëmbimin e informacionit për të dhënat e subjekteve që ushtrojnë veprimtari me leje të posaçme, të parashikuara në ligje të veçanta;

b) hartimin e programeve të punës për organizimin e kontrolleve të përbashkëta, sipas problematikës;

c) shkëmbimin e informacionit, në rastet e konstatimit të shkeljeve të legjislacionit që nuk mbulohen nga institucioni që kryen kontrollin;

ç) kryerjen e trajnimeve të përbashkëta për kualifikimin e specialistëve dhe të inspektorëve;

d) kryerjen e studimeve për çështje të përbashkëta, në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë;

dh) hartimin dhe zbatimin e projekteve që synojnë përmirësimin e sigurisë dhe të shëndetit në punë të punëmarrësve.

2. Ngarkohen Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.756, datë 15.9.2010

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.279, DATË 18.4.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PRODUKTEVE TË NDËRTIMIT, PËR TË
CILAT KËRKOHET VLERËSIMI I DETYRUAR I KONFORMITETIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 27 të ligjit nr.9779, datë 16.7.2007 “Për sigurinë e përgjithshme, kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të produkteve joushqimore” dhe të neneve 5, 6, 7 e 10 të ligjit nr.9290, datë 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e produkteve të ndërtimit, që i nënshtrohen vlerësimit të detyruar të konformitetit, të miratuar me vendimin nr.279, datë 18.4.2007 të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet sipas listës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Standardi që shfuqizohet	Emërtimi i produktit	Zëvendësohet nga standardi	Emërtimi i standardit
S SH EN 413-1:2004	Çimento për muraturë Pjesa 1:Specifikime	S SH EN 413-1:2006	Çimento për muraturë Pjesa 1: Specifikime
S SH EN 1916:2002	Tubat dhe aksesorët prej betoni, prej betoni të armuar dhe prej betoni me fibra çeliku	S SH EN 1916:2008	Tubat dhe rakorderi prej betoni i papërforcuar dhe i përforcuar me fibra çeliku
S SH EN 1917:2002	Dhoma inspektimi dhe puse lidhjesh prej betoni të paarmuar me shufra hekuri dhe të armuara	S SH EN 1917:2008	Puseta betoni dhe dhomëza inspektimi të papërforcuara dhe të përforcuara me fibra
S SH EN 12620:2002	Materiale inerte për prodhimin e betoneve	S SH EN 12620:2008	Agregate për beton
S SH EN 13986:2004	Pllaka me bazë druri për konstruksione Karakteristikat, vlerësimi i konformitetit dhe markimi	S SH EN 13986:2005	Panele me bazë druri për përdorim në ndërtim Karakteristikat, vlerësimi i konformitetit dhe markimi
S SH EN 13242:2002	Agregate për materiale lidhëse hidraulike dhe jolidhëse, për përdorim në industrinë civile dhe ndërtimin e rrugëve	S SH EN 13242:2007	Agregate për materiale hidraulikisht lidhëse dhe jolidhëse, për përdorim në inxhinierinë civile dhe ndërtimin e rrugëve
S SH EN 14411:2003	Pllaka qeramike Përkufizime, klasifikime/karakteristika dhe markimi	S SH EN 14411:2006	Pllaka qeramike Përkufizime, klasifikime/karakteristika dhe markimi

VENDIM
Nr.757, datë 15.9.2010

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE TË PROCEDURAVE, PËR SHITJEN E SIPËRFAQES SË DOMOSDOSHME TË TRUALLIT, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË NGA SHOQËRITË TREGTARE, KU SHTETI ZOTËRON KUOTA APO AKSIONE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9967, datë 24.7.2008 “Për miratimin e aktit normativ nr.4, datë 9.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”, dhe të nenit 8/2 të ligjit nr.9235, datë 24.7.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këtij vendimi i nënshtrohen të gjitha ato shoqëri tregtare, në të cilat shteti zotëron aksione apo kuota dhe të cilave trualli u është dhënë në përdorim apo me qira.
2. Ministri përgjegjës për ekonominë nxjerr urdhrin për shitjen e truallit të domosdoshëm të shoqërisë tregtare, në të cilën shteti zotëron aksione apo kuota dhe së cilës trualli i është dhënë në përdorim apo me qira.

3. Për fillimin e kësaj procedure, ministri përgjegjës për ekonominë, për përcaktimin e sipërfaqes së domosdoshme që do t'u shitet këtyre shoqërive për ushtrimin e veprimtarisë, nxjerr urdhrin për mbledhjen e komisionit, i cili të ketë në përbërje 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë vijon:

- Një përfaqësues të Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
- Një përfaqësues të Ministrisë së Financave;
- Një përfaqësues të institucionit, nga ka varësinë administrative shoqëria tregtare;
- Dy ekspertë vlerësues të pasurisë së paluajtshme, të licencuar.

4. Përcaktimi i kësaj sipërfaqeje bëhet në bazë të të gjithë dokumentacionit që disponon shoqëria, nga çasti i krijimit deri në çastin e daljes së urdhrit.

5. Me daljen e urdhrit përkatës, komisioni merr informacionin e duhur nga shoqëria dhe, nëse është e domosdoshme, u kërkon institucioneve të tjera shtetërore dokumentacion plotësues.

6. Ekspertët vlerësues hartojnë genplanin përkatës për sipërfaqen e domosdoshme për kryerjen e veprimtarisë së shoqërisë, si dhe genplanin e pjesës së mbetur të sipërfaqes, nisur nga genplani ekzistues i shoqërisë dhe dokumentet e tjera të saj, në 5 (pesë) kopje origjinale, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së informacionit përkatës për shoqërinë.

7. Komisioni, pas përgatitjes së këtyre genplaneve, i drejton institucionit të prefektit në territorin, ku ndodhet shoqëria, kërkesën për konfirmimin e tyre nga prefektura, e cila, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e marrjes së kërkesës përkatëse, konfirmon genplanin e paraqitur në pesë kopje origjinale dhe e përcjell dokumentacionin të nënshkruar dhe të vulosur nga ana e saj.

8. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me marrjen e dokumentacionit të sipërpërmendur, kryen procedurat e nevojshme në zbatim të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe, pas kryerjes së këtyre procedurave, ia dërgon dokumentacionin Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave.

9. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, me marrjen e dokumentacionit përkatës, i kërkon Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave konfirmimin, nëse ka vendime të dhëna nga ana e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronës, për sipërfaqen përkatëse të dy genplaneve, të konfirmuara nga prefektura, si dhe çmimin e shitjes së truallit përkatës, sipas hartës së çmimeve të trojeve, të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

10. Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, brenda (pesëmbëdhjetë) 15 ditëve nga data e marrjes së kërkesës, i dërgon Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, çmimin përkatës të shitjes së truallit, si dhe konfirmimin nëse ka vendime të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, duke e shoqëruar shkresën me një kopje të njëzuar me origjinalin, të këtyre vendimeve dhe planvendosjeve të tyre.

11. Pas marrjes së këtij informacioni, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, i dërgon një shkresë shoqërisë tregtare, ku i kërkon konfirmimin për blerjen e sipërfaqes së domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së saj, sipas genplanit të konfirmuar nga prefektura.

12. Shoqëria, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, i kthen përgjigje Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, ku shprehet se është dakord për blerjen e sipërfaqes së domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë së saj dhe, në të kundërt, nëse refuzon ta blejë këtë truall, ajo duhet të argumentojë arsyet e mosblerjes.

13. Në rastin e konfirmimit nga shoqëria të blerjes së sipërfaqes së domosdoshme për veprimtarinë e saj, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, brenda 5 (pesë) ditëve lëshon autorizimin përkatës, për kryerjen e pagesës së truallit, sipas legjislacionit në fuqi.

14. Shoqëria, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e lëshimit të autorizimit, kryen pagesën e truallit.

15. Në rastet e blerjes së truallit nga shoqëria, vlera e paguar nga ajo u kalon drejtpërdrejt subjekteve të shpronësuar, për kompensimin, nëse ka të tillë, sipas vendimeve përkatëse, të konfirmuara nga Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave.

16. Në rastet kur, sipas konfirmimit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk ka subjekte të shpronësuara për sipërfaqen përkatëse, vlera e truallit, e paguar nga shoqëria, kalon në fondin e kompensimit financiar për ish-pronarët.

17. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, i dërgon genplanin përkatës, të konfirmuar nga prefektura, për sipërfaqen e mbetur pas përcaktimit të sipërfaqes së domosdoshme për veprimtarinë e shoqërisë, Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, e cila kryen procedurën e kthimit fizik të kësaj sipërfaqeje subjekteve të shpronësuara, nëse ka të tillë, në të kundërt, kjo sipërfaqe përfshihet në fondin e kompensimit fizik të pronarëve.

18. Nëse shoqëria refuzon blerjen e tokës, brenda afatit të përcaktuar në pikën 18 të këtij vendimi, toka i kthehet fizikisht pronarëve të shpronësuar, nëse ka të tillë, sipas konfirmimit të Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Procedurat e kthimit, në këtë rast, kryhen nga kjo agjenci. Më pas, marrëdhëniet e shoqërisë tregtare me subjektin e shpronësuar, të cilit i është kthyer toka, rregullohen sipas dispozitave të Kodit Civil shqiptar në fuqi.

19. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse në zbatim të këtij vendimi.

20. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, institucioni i prefektit dhe organet e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.758, datë 15.9.2010

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS DHE KRITEREVE PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË BORDIT DREJTUES TË AGJENCISË SHQIPTARE TË ZHVILLIMIT TË INVESTIMEVE, NGA SEKTORI EKONOMIK PRIVAT, SI DHE MASËN E SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËTIJ BORDI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 3 të nenit 12 të ligjit nr.10 303, datë 15.7.2010 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përzgjedhja e katër anëtarëve të bordit drejtues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve, nga sektori ekonomik privat, bëhet me anë të konkurrimit.

2. Procedurat e konkurrimit bëhen nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe pas njoftimit në mediat e shkruara dhe elektronike.

3. Kriteret që duhet të plotësojë kandidati për në bordin drejtues janë këto:

- Të përfaqësojë një sektor të rëndësishëm të biznesit;
- Të jetë personalitet i njohur dhe aktiv në sektorin e biznesit të cilin përfaqëson;
- Të ketë përvojë drejtuese jo më pak se 7 (shtatë) vjet në fushën e sektorit që përfaqëson;
- Të ketë përvojë pune jo më pak se 12 (dymbëdhjetë) vjet në sektorin privat;
- Të rekomandohet, me shkrim, nga organizatat e biznesit për të qenë anëtar në bordin drejtues;
- Të mos jetë i dënuar penalisht;
- Të mos ketë detyrime ligjore ose proces gjyqësor ndaj tij.

4. Shpërblimi i anëtarëve të bordit drejtues të Agjencisë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve është 5000 (pesë mijë) lekë në muaj dhe përballohet nga buxheti i kësaj agjencie.

5. Ministri përgjegjës për ekonominë emërohet nënkryetar i bordit drejtues.

6. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.30, datë 7.9.2010

PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.10 270, DATË 22.4.2010 “PËR TË DREJTËN E PRIVATIZIMIT TË TRUALLIT SHTETËROR NË PËRDORIM DHE PËR TAKSËN MBI TË DREJTËN E PËRDORIMIT TË TIJ”

Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr.10 270, datë 22.4.2010 “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij”, Ministri i Financave

UDHËZON:

I. DEKLARIMI DHE PAGESA E TAKSËS SË TRUALLIT SHTETËROR NË PËRDORIM

1. Detyrimi për pagimin e taksës

Taksa mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror paguhet nga:

1.1 Individët që kanë në përdorim:

a) trojet e paprivatizuara të ndërtesave të privatizuara nga shtetasit me ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” (të shfuqizuar), sipas genplaneve në momentin e privatizimit të ndërtesave;

b) trojet e paprivatizuara të ndërtesave të shitura nga ndërmarrjet shtetërore, përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit” (të shfuqizuar), sipas genplaneve në momentin e shitjes së ndërtesave;

c) trojet e paprivatizuara, mbi të cilat janë ndërtuar ndërtesa, mbi bazën e lejeve të ndërtimit, të lëshuara nga komitetet pluraliste të këshillave, në periudhën e funksionimit të tyre, sipas genplaneve në kohën e lëshimit të lejes së ndërtimit.

1.2 Personat juridikë tregtarë dhe ndërmarrjet shtetërore, sipas parashikimit të ligjit të veçantë.

1.3 Personat juridikë tregtarë që, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, me një akt juridik të vlefshëm, përfitojnë të drejtën e përdorimit të trojeve shtetërore.

2. Detyrimi për pagimin e taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit ndaj personit fizik tregtar, bëhet për llogari të individit.

2. Detyrimi për raportimin e të dhënave

2.1 Personat që detyrohen ta paguajnë taksën mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror duhet të raportojnë në drejtoritë rajonale tatimore të dhënat për sipërfaqen e truallit në përdorim, vendndodhjen, si dhe aktin, në bazë të të cilit e gëzojnë të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror. Për raportimin e të dhënave sa më sipër për personat juridikë ngarkohen administratorët e personave juridikë, tregtarë, si dhe drejtuesit e ndërmarrjeve shtetërore.

2.2 Administrata tatimore qendrore, për të saktësuar rastet që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit nr.10 270, datë 22.4.2010, mund të kërkojë informacione shtesë në lidhje me truallin apo të dhëna të tjera që i nevojiten.

3. Llogaritja e detyrimit për t'u paguar

3.1 Taksa mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror është taksë vjetore. Brenda datës 15 shkurt të vitit pasardhës personat individë, që kanë në përdorim truall shtetëror dhe që detyrohen të paguajnë taksën, dorëzojnë, në drejtoritë rajonale tatimore, ku janë të regjistruar apo në territorin e të cilave banojnë, formularin e deklarimit të taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror, sipas formatit të miratuar me urdhër të Ministrit të Financave.

3.2 Deklarata për pagesën e taksës për të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror, për vitin 2010, bëhet brenda tre muajve nga hyrja në fuqi e ligjit nr.10 270, datë 22.4.2010 "Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij". Për vitin në vazhdim 2010, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të ligjit të mësipërm, taksa llogaritet proporcionalisht vetëm për periudhën e vitit të mbetur.

3.3 Detyrimi për taksën përcaktohet duke shumëzuar nivelin e taksës me vlerën e truallit shtetëror në përdorim. Niveli i taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror është 10 për qind e vlerës së truallit shtetëror në përdorim. Vlera e truallit përcaktohet duke shumëzuar sipërfaqen e truallit shtetëror në përdorim (të paprivatizuar) me çmimin e truallit/m².

3.4 Për përcaktimin e çmimit të truallit në vite të ndryshme, shërben harta përkatëse e vlerës së trojeve, e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me dispozitat e ligjit për kthimin dhe kompensimin e pronës.

3.5 Në rast se trualli në përdorim privatizohet nëpërmjet blerjes së tij, atëherë përllogaritja e taksës bëhet proporcionalisht vetëm për periudhën e vitit, gjatë të cilit është ushtruar e drejta e përdorimit të truallit shtetëror.

4. Pagesa e taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror

4.1 Taksa mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror paguhet në bankë, për llogari të organeve tatimore, brenda datës 15 shkurt të vitit pasardhës. Ekzekutimi i marrëveshjes së pagesës me këste nuk pezullon pagesën e plotë të taksës vjetore mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror.

4.2 Në rastet kur trualli në përdorim privatizohet dhe bëhet kërkesë për pagesë të menjëhershme të vlerës së truallit, sipas dispozitave të nenit 18 të ligjit, pezullohet detyrimi për pagesën e taksës vjetore mbi të drejtën e përdorimit të truallit.

4.3 Pezullimi i detyrimit hiqet në rastin kur individi heq dorë nga kërkesa e tij për blerjen dhe pagesën e menjëhershme të truallit, apo kur nuk paguan menjëherë detyrimin në ditën e caktuar nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronës Publike.

4.4 Në rastet e heqjes së pezullimit të detyrimit, llogaritja e taksës bëhet sikur pezullimi të mos ishte vendosur asnjëherë. Urdhri i pezullimit të detyrimit për pagesën e taksës dhe urdhri për heqjen e pezullimit bëhen nga Ministri i Financave.

4.5 Për vjeljen e taksës mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror ngarkohen drejtoritë rajonale tatimore.

5. Përgjashtimet nga pagesa e taksës të së drejtës së përdorimit të truallit shtetëror

5.1 Përgjashtohen nga pagesa e taksës të së drejtës së përdorimit të truallit shtetëror personat që zotërojnë truall shtetëror në përdorim në trojet turistike, për objektet dhe trojet e pranuar në proces legalizimi apo në trojet shtetërore, të dhëna me qëllim investimin mbi to, të cilat rregullohen nga ligje të tjera.

5.2 Individët që i nënshtrohen taksimit për të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror, nuk kanë më detyrimin për të paguar qira për truallin në përdorim.

6. Sanksionet

Kur nuk përbëjnë vepër penale, konsiderohen shkelje administrative dhe dënohen me gjobë, në përputhje me ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar:

-Plotësimi në mënyrë të pasaktë i formularit të deklarimit;

- Mosdorëzimi në kohë i formularit të deklarimit të taksës; apo
- Mospagesa në afat e detyrimit për taksën mbi të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror.

II. PRIVATIZIMI I TRUALLIT SHETËTOR

1. Individët, që kanë privatizuar objekte, ndërmarrje, apo kanë ndërtuar mbi bazën e lejeve të ndërtimit, sipas ligjit nr.10 270, datë 22.4.2010, por që nuk kanë privatizuar sipërfaqen e truallit, sipas genplanit të dokumentacionit të privatizimit apo lejes së ndërtimit, mund ta blejnë këtë truall sipas përcaktimeve të mëposhtme.

2. Privatizimi në favor të personit fizik tregtar, bëhet për llogari të individit.

1.1 Privatizimi i truallit me shlyerje të menjëhershme të pagesës

a) Nëse individ që ka truall në përdorim, paraqet pranë Ministrisë së Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, një kërkesë për pagesë të menjëhershme të vlerës së truallit, i cili kërkohet të privatizohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, deri më datë 7.12.2010, dhe këtë pagesë e realizon brenda 30 ditëve nga data e pajisjes me autorizim për kalim pronësie trualli nga ana e Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, përfiton një ulje prej 20 për qind të vlerës dhe 20 për qind të vlerës së mbetur mund ta paguajë me bono privatizimi.

b) Nëse individ e paraqet këtë kërkesë për pagesë të menjëhershme të vlerës së truallit, pas datës 7.12.2010 dhe kjo pagesë realizohet brenda 30 ditëve nga data e pajisjes me autorizim për kalim pronësie trualli nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, subjektet përfitojnë një ulje prej 20 për qind të vlerës. Nuk përfitojnë nga këto ulje ata të cilët e paraqesin kërkesën e tyre për blerje trualli pas datës 7.6.2011.

1.2 Privatizimi i truallit me shlyerje të pagesës me këste

a) Nëse individ që ka truall në përdorim, paraqet pranë Ministrisë së Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, një kërkesë për pagesë të vlerës së truallit, i cili kërkohet të privatizohet, së bashku me dokumentacionin përkatës, si dhe dokumentin e lëshuar nga organi kompetent që vërteton se subjekti ka paguar rregullisht taksën e së drejtës së përdorimit të truallit shtetëror, ai mund të kërkojë lidhjen e një marrëveshjeje për të kryer pagesën e truallit me këste.

b) Marrëveshja (kontrata) e pagesës me këste lidhet ndërmjet Drejtorit të Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, pranë Ministrisë së Financave dhe subjektit. Afati maksimal i lidhjes së marrëveshjes së pagesës me këste do të jetë 12 muaj nga data e nënshkrimit të saj.

c) Shuma dhe koha e pagesës së kësteve përcaktohen nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në kontratën që do të firmoset nga palët.

2. Nëse individ paraqet pranë Ministrisë së Financave, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike një kërkesë, së bashku me dokumentacionin përkatës për pagesë të vlerës së truallit në përdorim, sipërfaqe të domosdoshme, pas datës 7.12.2010, apo ai heq dorë nga kërkesa e bërë përpara kësaj date për pagesë të menjëhershme ose nga ajo me këste, apo nuk respekton afatet e pagesave të përcaktuara në marrëveshjen e pagesës, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave u kërkon organeve përkatëse të qeverisjes vendore apo çdo organi tjetër shtetëror, me të cilin ata kanë lidhur kontratë qiraje për truallin, vërtetimin për pagesën e qirasë së truallit, për objektin, ndërmarrjen apo ndërtesën e ndërtuar mbi bazën e lejes së ndërtimit, nga subjekti kërkues deri në datë 7.6.2010, koeficientin e llogaritjes së bashkëpronësisë së truallit (organi i qeverisjes vendore), për rastet kur objekti është me dy apo më shumë kate duke i dërguar dhe dokumentacionin përkatës. Në këto raste, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike u kërkon drejtorive rajonale tatimore vërtetimin për pagesën e taksës së truallit, për objektin, ndërmarrjen apo ndërtesën e ndërtuar sipas lejes së ndërtimit nga subjekti kërkues.

3. Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave, pas marrjes së dokumentacionit të nevojshëm nga organet e qeverisjes vendore, Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme apo organet e tjera shtetërore, njofton kërkuesin për t'u paraqitur pranë këtij institucioni, për t'u njohur me vlerën e truallit që ai kërkon të privatizojë, si dhe për të marrë autorizimin për pagesën e vlerës së truallit.

Pagesa kryhet brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të autorizimit, si dhe jo më vonë se 12 muaj nga data e lidhjes së marrëveshjes. Pas kryerjes së pagesës së vlerës së plotë të truallit, Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave, në Ministrinë e Financave, lidh kontratën e shitjes së truallit me blerësin.

4. Pagesa e qirasë së truallit në përdorim sipërfaqe të domosdoshme për subjektet, që e kanë paguar dhe që duhet ta paguajnë rregullisht atë deri më datën 7.6.2010, për objektin, ndërmarrjen apo ndërtesën e ndërtuar sipas lejes së ndërtimit, bëhet në zbatim të akteve ligjore a nënligjore, sipas periudhave përkatëse dhe kontratave të qirasë, të lidhura për këtë qëllim, është me një çmim vjetor sa 1/10 e vlerës së truallit.

5. Individët, të cilët kanë bërë kërkesë për privatizimin e truallit në përdorim sipërfaqe të domosdoshme përpara datës 7.6.2010, do të vazhdojnë procedurën për privatizimin e tij sipas procedurave të përcaktuara në këtë udhëzim, por me kushtin që të përsërisin kërkesën për mënyrën e realizimit të pagesës të vlerës së truallit brenda datës 7.6.2011.

6. Ky udhëzim nuk do të zbatohet për procedurat e vlerësimit të truallit të objekteve apo ndërmarrjeve, dokumentacioni i të cilave është në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në Ministrinë e Financave dhe ndodhen në fazën kur ka përfunduar pagesa për vlerën e plotë të tyre.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCE
Ridvan Bode

URDHËR
Nr.63, datë 7.9.2010

PËR MIRATIMIN E FORMULARIT TË DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TAKSËS MBI TRUALLIN SHTETËROR NË PËRDORIM

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 7 pika 2 të ligjit nr.10 270, datë 22.4.2010 “Për të drejtën e privatizimit të truallit shtetëror në përdorim dhe për taksën mbi të drejtën e përdorimit të tij”, Ministri i Financave

URDHËRON:

1. Miratimin e formularit të deklarimit dhe pagesës së taksës mbi truallin shtetëror në përdorim”, sipas formatit dhe udhëzimeve bashkëlidhur.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCE
Ridvan Bode



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

FORMULARI I DEKLARIMIT DHE PAGESËS SË TAKSËS MBI TRUALLIN SHTETËROR NË
PËRDORIM

Numri i vendosjes së dokumentit (NVD) (Vetëm për përdorim zyrtar)	
1. Periudha tatimore	2.Nr.i deklarimit
a) Numri i identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT-i)	
b) Emri tregtar i personit të tatueshëm	
c) Emri, mbiemri i individit	
d) Adresa:	
e) Numri i telefonit	
Llogaritja e taksës për truallin në përdorim	
3. Sipërfaqja e truallit shtetëror në përdorim në m ²	x
4. Çmimi i truallit shtetëror në përdorim në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave	x
5. Niveli i taksës	x
6. Taksa vjetore e llogaritur (3x4x5)	x
7. Muaj të truallit shtetëror në përdorim	x
8. Taksa për t'u paguar (6/12x7)	x
Të dhëna shpeshë mbi sipërfaqen e truallit shtetëror në përdorim	
9. Numri i aktit ligjor mbi bazën e së cilës zotërohet trualli shtetëror në përdorim	x
10. Vendndodhja e truallit shtetëror në përdorim	x
11. Genplani i bashkëlidhur	
Shënim. Në çdo deklaram do të plotësohen pikat 1 dhe 2 për të dhënat shpeshë, ndërsa genplani do të dorëzohet vetëm një herë.	

Deklaroj nën përgjegjësinë time që informacioni i mësipërm është i plotë dhe i saktë.

Data ____ / ____ / ____ /

Firma e personit të tatueshëm

Vetëm për përdorim zyrtar

PAGESA

Lekë
Xhirim
Çek
Të tjera

Shuma e paguar

Kopja-Personi i tatueshëm
Origjinali-Zyra e tatimit

Data, vula e bankës, nënshkrimi i nëpunësit të bankës

**SQARIME MBI PLOTËSIMIN E FORMULARIT, TË DEKLARIMIT TË PAGESËS SË TAKSËS
MBI TRUALLIN PËR PËRDORIM**

1. Periudha tatimore: Poshtë emërimit do të shënohet viti fiskal për të cilin bëhet deklarimi.
2. Numri i deklaratës së truallit shtetëror në përdorim për të cilat bëhet deklarimi. Për çdo vendndodhje truall në përdorim do të bëhet një deklaratë e veçantë.
 - a) Numri i identifikimit të personit të tatueshëm (NIPT) i personit juridik apo fizik. Individët e paregjistruar si persona tregtarë do të vendosin numrin e kartës së identitetit dhe në mungesë të saj numrin e pasaportës.
 - b) Emri tregtar i personit të tatueshëm; sipas regjistrimit në organin tatimor.
 - c) Emri, mbiemri i individit që zotëron truall në përdorim dhe paguan taksën.
 - d) Adresa sipas rastit e personit juridik, fizik apo individit, që zotëron truall shtetëror në përdorim dhe paguan taksën.
 - e) Numri i telefonit sipas rastit i personit juridik, fizik apo individit që zotëron truall shtetëror në përdorim dhe paguan taksën.
3. Sipërfaqja e truallit shtetëror në përdorim në m² që zotërohet sipas aktit ligjor.
4. Çmimi i truallit shtetëror në përdorim në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave, në përputhje me nenin 5 të ligjit nr.10 270, datë 22.4.2010.
5. Niveli i taksës i miratuar me ligj.
6. Taksa vjetore e llogaritur, që del nga shumëzimi i rubrikave (3x4x5).
7. Muajt e truallit në përdorim tregojnë numrin e muajve për periudhën fiskale përkatëse, për të cilat subjekti gëzon të drejtën e përdorimit të truallit shtetëror.
8. Taksa për t'u paguar: del nga pjesëtimi i rubrikës 6 me 12 (muaj) dhe rezultati që del nga pjesëtimi shumëzohet me rubrikën 7.
9. Numri i aktit ligjor mbi bazën e të cilit zotërohet truallit shtetëror në përdorim.
10. Vendndodhja e truallit në përdorim tregon vendndodhjen e truallit shtetëror në përdorim për të cilën bëhet deklarimi.

VENDIM
Nr.56, datë 31.8.2010

**PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PARAPRAK PËR KRYERJEN E VEPRIMTARISË SHITESË
NGA BANKA CREDINS SHA**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 12 shkronja “a”, nenit 43, shkronja “e” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 23, pikat 1 dhe 3, nenit 24, pika 1 shkronja “ç”, të nenit 54, pika 2, shkronja “dh”, nënpika “vi” të ligjit nr.9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të japë miratimin paraparak për kryerjen nga Banka Credins sh.a. të veprimtarisë financiare shtesë, si më poshtë:

“- Tregtimin për llogari të saj ose për llogari të klientëve, qoftë dhe në një këmbim valutor, në një treg të vetorganizuar (OTC) ose ndryshe për veprimet me arin.”

2. Autorizohet Guvernatori i Bankës së Shqipërisë për të kryer ndryshimet përkatëse në aneksin e licencës së Bankës Credins sh.a., sipas pikës 1 të këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për zbatimin e këtij vendimi.

4. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritetit Europian dhe Komunikimit, për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë, dhe në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM
Nr.62, datë 31.8.2010

PËR TËRHEQJEN NGA QARKULLIMI TË KARTËMONEDHAVE ME KURS LIGJOR

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b” të nenit 40, pika 5, të nenit 43, shkronja “c” dhe “d” të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të kreut II të udhëzimit “Për hedhjen në qarkullim të prerjeve të reja të kartëmonedhave dhe monedhave kombëtare e për tërheqjen nga qarkullimi i parasë”, miratuar me vendimin nr.27, datë 30.3.1998 të Këshillit Mbikëqyrës; të kreut II, pika 5 e rregullores “Për funksionimin e Departamentit të Emisionit”, miratuar me vendimin nr.21, datë 28.3.2001 të Këshillit Mbikëqyrës, të ndryshuar, dhe me propozim të Departamentit të Emisionit, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë

VENDOSI:

1. Të miratojë tërheqjen nga qarkullimi të kartëmonedhës me kurs ligjor, si më poshtë:

a) Kartëmonedha e prerjes 1000 lekë, emetim i vitit 1992, 1994, 1995, 1996, imazhi i Skënderbeut.

2. Kartëmonedha me prerjen dhe emetimet e përcaktuara, sipas pikës 1 të këtij vendimi do të ketë kurs ligjor, deri në datën 31.3.2011.

3. Kartëmonedha me kurs ligjor, sipas përcaktimeve të pikës 1 të këtij vendimi, do të mbledhet për këmbim kundrejt pagesës së vlerës fillestare të emetimit, me kartëmonedha dhe monedha të tjera në qarkullim, deri në datën 31.12.2013.

4. Ngarkohen të gjitha bankat, degët e bankave të huaja dhe zyrat e këmbimit valutor të pranojnë për këmbim, deri në datën 31.12.2013, kartëmonedhat me kurs ligjor, sipas përcaktimeve

të pikës 1 të këtij vendimi, dhe t'i dërgojnë ato menjëherë pranë Bankës së Shqipërisë dhe degëve të saj.

5. Ngarkohet Departamenti i Emisionit dhe Departamenti i Kontabilitetit dhe Financës me zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohet Departamenti i Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit Europian dhe Komunikimit për publikimin e këtij vendimi në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë.

KRYETARI
Ardian Fullani

VENDIM
Nr.57, datë 8.9.2010

PËR MIRATIMIN E STUDIMIT TË HUMBJEVE TEKNIKE PËR VITIN 2009

Në mbështetje të pikës 4.5 të deklaratës rregullatore, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.12, datë 3.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.9.2010, pasi analizoi studimin e humbjeve të kryer nga eksperti i pavarur “Pricewaterhouse Coopers” dhe të paraqitur nga OSSH sh.a., dhe relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike,

VENDOSI:

1. Të miratojë studimin e humbjeve teknike të paraqitur nga OSSH sh.a.
2. Të përcaktojë nivelin e humbjeve teknike për vitin 2009, në masën 15.2% si pjesë e nivelit total të humbjeve në sistemin e shpërndarjes, të përcaktuar në vendimin nr.46, datë 14.6.2010 “Mbi kërkesën e OSSH sh.a., lidhur me nivelin e humbjeve të energjisë elektrike për vitin 2008.”
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OSSH sh.a. për këtë vendim.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.58, datë 8.9.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË LICENCIMIT TË SHOQËRISË “RUDNAP
ENERGY TIRANA” SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 8 pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pikat 1, germa “d” të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1, germa “g”, nenit 10 pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108 datë 9.9.2008, dhe nenit 18, pikat 1, germa “a”, dhe 3 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve, nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregulator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.9.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4.10).

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me bilancin e tri viteve të fundit të shoqërisë është në pritje për t’u plotësuar (neni 9 pika 3, germa “c”).

Për gjithë sa më sipërcituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licencë të shoqërisë “Rudnap Energy Tirana” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.59, datë 8.9.2010

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HYDROENERGY” SHPK, NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, neneve 9 dhe 13 pika 1, germa “d” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4 pika 1, germa “g”, neneve 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.9.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “HydroEnergy” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson tërësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4.10).

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë “HydroEnergy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.60, datë 8.9.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ANSARA
KONCENSION” SHPK**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2 germa “a”, 9 dhe 13 pika 1, germa “a”, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenit 4, pika 1, germa “a”, dhe të nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, të nenit 18, pika 1, germa “a” të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.9.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Ansara Koncension” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4).

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me paraqitjen e lejes së përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike dhe lejes mjedisore nga organet përkatëse, janë në proces përfundimi (neni 9 pika 4.1.5, geramat “b” dhe “c”).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licencë të shoqërisë “Ansara Konkension” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Labinot-Mal-Elbasan”.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.61, datë 13.9.2010

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT TË APLIKIMIT TË OSSH SHA PËR MIRATIMIN E PLANT TË INVESTIMEVE TË VITIT 2011

Në mbështetje të neneve 9 dhe 24 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të nenit 10 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2010, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OSSH sh.a. dhe u njoh me relacionin e përgatitur nga grupi i punës,

konstatoi se:

Aplikimi i OSSH sh.a. për planin e investimeve për vitin 2011 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e neneve 10 dhe 11 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për shqyrtimin e aplikimit të OSSH sh.a. për miratimin e planit të investimeve të vitit 2011.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.62, datë 13.9.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KESH SHA PËR VITIN 2011**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 18, 20 dhe 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009 vendimit nr.77, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike për vitin 2011 dhe relacionin e grupit të punës,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së prodhimin të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për vitin 2011.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.63, datë 13.9.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR FURNIZUESIN PUBLIK ME SHUMICË PËR VITIN 2011**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 20, 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, të vendimit nr.78, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë, për vitin 2011 dhe relacionin e grupit të punës,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për aktivitetin e furnizimit publik me shumicë për vitin 2011.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.64, datë 13.9.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OST SHA PËR VITIN 2011**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 18, 20 dhe 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.59, datë 29.12.2005 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e OST sh.a. për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a. për vitin 2011,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a. për vitin 2011.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.65, datë 13.9.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË
SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OSSH SHA PËR VITIN 2011**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 18, 20, 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.79, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e OSSH sh.a. për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike për OSSH sh.a., për vitin 2011 dhe relacionin e grupit të punës,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike për OSSH sh.a. për vitin 2011.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.66, datë 13.9.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË FURNIZIMIT
PUBLIK ME PAKICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OSSH SHA PËR
KONSUMATORËT TARIFORË**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të neneve 18, 20, 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.80, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e OSSH sh.a. për përcaktimin e tarifës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për konsumatorët tariforë, për vitin 2011 dhe relacionin e grupit të punës,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së furnizimit publik me pakicë të energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për konsumatorët tariforë për vitin 2011.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.67, datë 13.9.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E TARIFËS SË LIDHJES SË RE
APO MODIFIKIMIT TË LIDHJES EKZISTUESE NË RRJETIN ELEKTRIK TË OST SHA**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 18, pika 1, germa “c”, të miratuar me vendimin nr.21, datë 18.3.2009, dhe pikës V.3.3, të Kodit të Rrjetit të Transmetimit, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.123, datë 24.10.2008, të pikës 3.8.2 të licencës për aktivitetin e transmetimit, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.35, datë 9.7.2004, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e OST sh.a. dhe relacionin përkatës të grupit të punës mbi fillimin e procedurave për miratimin e tarifës së lidhjes së re apo modifikimit të lidhjes ekzistuese në rrjetin elektrik të OST sh.a.,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin e tarifës së lidhjes së re apo modifikimit të lidhjes ekzistuese në rrjetin elektrik të OST sh.a.
2. Ngarkohen drejtoritë teknike të njoftojnë OST-Në për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe ndjekjen e mëtejshme të procedurave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.68, datë 13.9.2010

**PËR SHTYRJEN E AFATIT PËR REALIZIMIN E KUSHTEVE TË VENDOSURA NGA
ERE, SHOQËRISË “ALB WID ENERGY” SHPK**

Në mbështetje të neneve 9, 13, pika 1, germa “a”, dhe 15 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 128 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 13.9.2010, pasi shqyrtoi informacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për shtyrjen e afateve për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE, shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k.,

dhe duke konsideruar:

Kompleksitetin e problematikës që i licencuari ka hasur për kryerjen dhe dorëzimin e studimit të fizibilitetit të bazuar në matje reale, dhe duke qenë se ndërtimi dhe instalimi i parqeve eolike, përveç vonesave administrative në të cilat ka kaluar, ka pësuar edhe dëmtime gjatë këtij viti,

VENDOSI:

1. Të shtyjë me 24 muaj afatet e përcaktuara në vendimin nr.81, datë 4.11.2009 “Për shtyrjen e afatit për realizimin e kushteve të vendosura nga ERE, shoqërisë “Alb Wind Energy” sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut tA njoftojë shoqërinë për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Bujar Nepravishta

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
PËRMBLEDHJE E AKTEVE NDËRKOMBËTARE PËR DREJTËSINË	660 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PASURITË E PALUAJTSHME	328 lekë
PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE	260 lekë
VENDIME UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 29.9.2010
Doli nga shtypi më 1.10.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 36 lekë